

**MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN ZALL-HERR TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Zall-Herr, Tiranë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Krujë, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe vetëm blerjet e vogla për periudhën 2009-2010*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 169, datë 30.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 575/6, datë 22.11.2013, i ka rekomanduar z. Genci Alushi, Drejtor i Shërbimit Spitalor Krujë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

1. Për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

1. Duke qenë se përcaktimi i afateve të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara nuk është i parashikuar në ligjin nr. 8312, datë 26.02.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*”, por ato përcaktohen vetëm në UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara*”, është kërkuar që në ligjin nr. 8312, datë 26.02.1998 të caktohen afatet e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara si dhe të merret parasysh dhe neni 803 i Kodit Civil, i cili ka përcaktuar se këto kontrata kanë fuqi vetëm për një afat prej 30 vjetësh.

2. Gjithashtu është kërkuar që në ligjin nr. 8312, datë 26.02.1998 “*Për tokat bujqësore të pandara*” dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara*” të vendoset edhe një përcaktim, se tokat bujqësore, të pandara mund të jepen me qira, vetëm në rast se nuk ka pretendues nga subjektet e shpronësuara (ish-pronarët).

2. Për Ministrinë e Mjedisit,

Në kushtet kur me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”, një pjesë e pasurisë pyjore ka kaluar në pronësi të komunave, del e nevojshme plotësimi i ligjit me aktet nënligjore, si VKM apo Udhëzim dhe Kontratat TIP, duke i ngarkuar me detyra edhe njësitë e qeverisjes vendore **dhe konkretisht:**

-Ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 “*Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore*”,

-Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “*Për fondin kullor*”.

-VKM nr. 831, datë 28.12.1998 “*Për mënyrën e dhënies me qira të tokës bujqësore, pyjore dhe bimësi pyjore, pasuri shtetërore*”, i ndryshuar me VKM nr. 6, datë 13.1.2000 dhe nr. 152, datë 22.3.2001, ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”.

-Udhëzimin e MMPAU nr. 1, datë 02.07.2012 “*Për përcaktimin e kritereve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik*”.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Kryetari i Komunës Zall-Herr, të ndërmerren aktet administrative të domosdoshme përmes të cilave të kërkohet arkëtimi i detyrimeve të **papaguara deri më datën 31.12.2012 nga 45 subjekte** në vlerën **2,590,927 lekë**.

Në rast se subjektet nuk pranojnë të paguajnë taksat vendore, pasi të aplikohen masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit), ndaj 5 subjekteve të biznesit të madh me aktivitet "Prodhim Inertesh" dhe 30 subjekteve të Transportit të mallrave të cilët nuk kanë paguar taksa prej 2 vjetësh, të kërkohet zbatimi i Kodit Penal.

2. Nga ana e Komunës Zall-Herr, të merren masa ndaj 17 subjekteve që të kryejnë regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), të cilët rezultojnë të paregjistruar, duke u llogaritur e kërkuar arkëtimin e detyrimit për periudhën e 2 viteve 2011-2012, në vlerën **283,498 lekë**.

3. Në vlerën **324,997 lekë**, ndaj 15 personave të cilëve për mos kryerje të pagesave të qirasë së tokës, sipas afateve të parashikuara në kontratë, u llogariten kamat vonesat në masën 0,1% në ditë, detyrime këto të përcaktuar dhe llogaritura sipas kushteve të kontratave të lidhura, si dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007.

4. Nga zyra e taksave të komunës Zall-Herr, të kryhen llogaritjet dhe të aplikohet dënim me gjobë "Për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve të taksave vendore", duke kërkuar arkëtimin e tyre.

5. Nga ana e zyrës së financës dhe magazinieres, të hapen analizat e llogarive (partitarët) për të gjitha llogaritë që do preken gjatë regjistrimit në ditarët analitikë, si dhe, të ngrihet komision për inventarizimin e aktiveve të trupëzuara (mjetet kryesore).

6. Nga ana e Komunës Zall-Herr, të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si; data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj.

7. Nga ana e zyrës së financës, të ushtrohet kontroll i befasishëm një herë në muaj i arkës dhe i letrave me vlerë dhe veprimtarive të tjera që krijojnë dhe qarkullojnë vlera monetare.

8. Nga ana e zyrës së shërbimeve të komunës, të merren masa për lidhjen e kontratave me konsumatorët e ujit të pijshëm, njihjen e detyrimeve përkatëse duke aplikuar edhe kamat vonesa.

9. Komuna Zall-Herr, të marrë masa dhe të kryej të gjitha procedurat administrative ligjore për deklarimin të pavlefshëm të 188 kontratave të qirasë së tokave të pandara me sipërfaqe 360 ha, pasi procesi i kalimit të pronave në pronësi të komunës ende nuk ka përfunduar, duke mos zbatuar VKM nr. 500, datë 14.8.2001 i ndryshuar me VKM nr. 1277, datë 23.12.2009.

10. Dhënia me qira e tokave bujqësore është kryer pa i pasur ato në pronësi, duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

Kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara të Komunës Zall-Herr, janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë në kundërshtim edhe me sa përcakton neni 678 e vijues i Kodit Civil dhe neni 32 i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000.

Nga 188 kontrata të lidhura për dhënien me qira të tokave të pandara, me sipërfaqe prej 360 ha, në 106 prej tyre me sipërfaqe prej 160 ha, kontratat e lidhura me qeramarrësit nuk janë TIP (sipas formatit ligjor) dhe në to nuk janë vendosur sanksione, për të cilat nuk mund të llogariten kamat vonesa, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip" të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore" dhe me UKM nr. 3, datë 16.05.2007, ndryshuar me nr. 1, datë 18.07.2012.

11. Komuna Zall-Herr, të marrë masa dhe të kryej procedurat administrative bazuar në nenet 115, 116/c, 117 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Për Kodin e Procedurës Administrative" për deklarimin të pavlefshëm të 9 kontratave të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara për aktivitet biznesi në periudhën nga viti 2008-2012.

Gjatë periudhës së dërgimit të projektraportit të auditimit, nga kryetari i komunës, ka dalë urdhëri nr. 64, datë 23.09.2013 për anulimin e 7 kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pafrytshme, pavarësisht nga kjo, të vazhdojë procedurat për deklarimin e

pavlefshëm të 9 kontratave për sipërfaqen e tokës 45.2 ha, konsideruar nga Komuna si të pafrytshme.

12. Komuna Zall-Herr, të marrë masa që të shqyrtojë në këshillin e Komunës 6 rastet e dhënies me qira të tokës pyjore, sipërfaqen 7.5 ha, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, neni 32, shkronja (ë) detyrat e këshillit bashkiak ose komunal, ku parashikohet se: *“Këshilli i komunës miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve...”*.

13. Komuna Zall-Herr, të marrë masa dhe të rishqyrtojë në këshillin e komunës 3 vendimet për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës pyjore respektivisht; nr. 07, datë 30.01.2013, nr. 28, datë 23.10.2012 dhe nr. 30, datë 23.10.2012. Këto 3 vendime ti dërgojë në Prefekturën e Qarkut Tiranë, për tu shprehur në lidhje me ligjshmërinë e tyre, siç, përcaktohet në ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 *“Për Prefektin”*, neni 14 -Verifikimi i ligjshmërisë së akteve.

14. Komuna Zall-Herr, të mos lidhë kontratat për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës pyjore, vendosur nga këshilli i komunës për 3 persona në sipërfaqen 7,3 ha, respektivisht me vendimet; nr. 26, 27 dhe nr. 29, datë 23.10.2012. Këto 3 vendime ti dërgojë në Prefekturën e Qarkut Tiranë, për tu shprehur në lidhje me ligjshmërinë e tyre, siç përcaktohet në ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 *“Për Prefektin”*, neni 14 -Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”.

15. Për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të administratës së Komunës, Zall-Herr, miratuar me VKB nr. 17, datë 05.05.2009 *“Për miratimin e rregullores së brendshme të administratës Komunës Zall-Herr”*, ku të përcaktohen struktura me detyra të qarta, rregulla për kontrollin e brendshëm, ndjekjen e procedurave ligjore në lidhje me ndjekjen e kontratave të qirave të tokave bujqësore të pandara dhe sipërfaqeve pyjore, funksionimin e aktivitetit të ujësjellësit, etj.

Të përcaktohen rregulla për administrimin, ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme dhe vënien në efikasitet të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kap. III.

16. Të merren masa që Policia e komunës të pajiset me dokumente format *“Proces verbal”* dhe *“Vendim gjobe”*, me numër serial progresiv. Këto dokumente të administrohen si letra me vlerë duke i inventarizuar dhe regjistruar në kontabilitet, në zbatim të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011, Kap IV- Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve.

17. Nga Policia e komunës për rastet e konstatimit të shkeljeve të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, të vendosen gjobat e përcaktuara në VKB nr. 36, datë 15.12.2011 *“Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2012”*, në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998.

18. Nga ana e Zyrës së Taksave dhe e Policisë, të merren masa, që përveç llojeve të kundërvajtjeve administrative të përcaktuara në VKB nr. 36, datë 15.12.2011 *“Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2012”*, të propozojnë dhe miratojnë paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në zbatim të nenit 6 *“Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”* të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*.

19. Të merren masa për zëvendësimin e shefit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës i diplomuar për Mjek Veteriner i Lartë dhe Jurist, emërim i cili është në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 11 Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik”.

20. Në kuadrin e mosmbulimit me punë gjithë vjetore të 2 punonjësve të INUV i Komunës, të shikohet mundësia që kjo detyrë të mbulohet nga INU i Këshillit të Qarkut. Komuna Zall-Herr, që bazuar në nenin 18 pika 3 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *“Për inspektimin e ndërtimit”* i ndryshuar, të lidhë marrëveshje me Këshillin e Qarkut Tiranë.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 *“Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”*, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* Kap IV, -Sistemi i

kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe **nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 2,481,307 lekë, si më poshtë:**

1. Në vlerën **31,112 lekë ndaj znj. F.A.** mbikëqyrëse e punimeve, sa paguar më tepër nga llogaritja e gabuar e pagesës së mbikëqyrëses, gjatë vitit 2011, në kundërshtim me tarifën e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 95.09.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”.

2. Në vlerën **48,000 lekë, ndaj 5 punonjësve** të administratës së Komunës Zall-Herr, sipas urdhër shpenzimit nr. 24, datë 02.03.2011 për vlerën 30,000 lekë dhe urdhër shpenzimi nr. 28, datë 02.03.2012 për vlerën 30,000 lekë, paguar shpërblime me rastin e festës së 8 Marsit, në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, ndryshuar me VKM nr. 826, datë 5.12.2011 për vitin 2011 dhe për vitin 2012 në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 849, datë 06.12.2012.

3. Në vlerën **163,100 lekë, ndaj** shoqërisë “X & Y”, sa është paguar padrejtësisht, pasi në preventivin e ofertës dhe situacionin përfundimtar të objektit “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare “Kasallë”, për vitin 2011, është përfshirë edhe vlera e pajisjeve së bashku me TVSH, duke rritur artificialisht fondin limit dhe kontratën, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003, Kreut I, pika 1, A, ku përcaktohet: “Në punimet e ndërtimit në të gjitha rastet përjashtohen aparaturat dhe pajisjet”.

4. Në vlerën **133,226 lekë, ndaj** 16 personave, të cilët nuk kanë kryer pagesat e vlerës së qirasë së tokës sipas afateve të përcaktuara në kontratat përkatëse. Në kundërshtim me kontratat e lidhura dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

5. Në vlerën **1,616,015lekë, ndaj** 20 personave të cilëve nga moskryerja e pagesave të qirasë së tokës, sipas afateve të parashikuara në kontratë, u llogaritën kamat vonesa në masën 0,1% në ditë. Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në kontratat e lidhura dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007.

6. Në vlerën prej **213,954 lekë, ndaj** punonjësve të aparatit të komunës, kryepleqve dhe anëtarëve të këshillit Zall-Herr, për sa nuk kanë paguar taksën e tokës dhe banesave për vitin 2011-2012, në zbatim të neneve 11 dhe 14 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe neneve 68, 69, 70, 74, 76 dhe 111, të ligjit 9920, datë 19.05.2008.

7. Në vlerën **275,900 lekë, ndaj 32 konsumatorëve familjarë**, sa nuk kanë paguar detyrimet e ujit të pijshëm për periudhën e vitit 2011- 2012 të cilat nuk janë kontabilizuar si debitorë. Në zbatim të pikës 4 të VKM nr. 236, datë 10.05.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.2007 dhe udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për administrimin e ujit të pijshëm.

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në Kontratën individuale të punës, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Zall-Herr, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **16 punonjësve**, si më poshtë:

a. Zgjidhje e kontratës së punësimit: bazuar në nenin 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, **për 2 personat e mëposhtëm:**

1. F.L. ing. topograf i komunës, përfaqësuesi i urbanistikës të komunës, në cilësinë e anëtarit të Bordit të dhënies me qira të tokave të pandara (shkurt BQTBP-ja), për veprime në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", ndryshuar me nr. 1, datë 18.07.2012, pika 2, 3/d, 6 (a, b, c), 11 dhe 14.

2. H.B. me detyrë, shefi i zyrës juridike dhe Inspektoratit ndërtimor urbanistik të komunës, Zall-Herr, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Kodin e Procedurës Administrative dhe me sa përcakton neni 678 e vijues të Kodit Civil, Urdhrit të Ministrisë së Bujqësisë nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës Tip" për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore" dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007.

3 H.B. në cilësinë e juristit të komunës Zall-Herr dhe personit të caktuar me mbajtjen e protokollit të mbledhjeve të Bordit, nuk ka përmbushur detyrën, në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 2 -Kryetari dhe sekretari, neni 16 Procesverbalit i mbledhjes, neni 17 -Përfshirja në procesverbal e votave "kundër".

b."Vërejtje me paralajmërim", për 5 punonjësit e mëposhtëm:

1. I.M. me detyrë ish-specialiste e financës, aktualisht shefe e financës, për veprime në kundërshtim me nenin 95 "Regjistri" të ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995," Kodi i Punës", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kap I, "Mbajtja e kontabilitetit", pika 2 shkronja (c),"Dokumentet e kontabilitetit", pika 2.3 "Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit", pikën 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kap III-të, -Regjistri i Aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre.

2. J.R. me detyrë ish-shefi i financës, aktualisht përgjegjës i zyrës së taksave, për veprime në kundërshtim me pikën 80, Kap IV, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësisë të sektorit publik", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kap I, "Mbajtja e kontabilitetit", pika 2 shkronja (c), "Dokumentet e kontabilitetit", pika 2.3 "Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit" dhe nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

3. K.L. me detyrë arkiviste dhe magazinierë, për veprime në kundërshtim me pikën 60 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Kap III-të, -Regjistri i Aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre.

4. XH.XH. ish-shef i zyrës së taksave, për vitet 2011-2012 dhe përpara, aktualisht shef i zyrës së shërbimeve, për veprime në kundërshtim me nenin 91 dhe 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore".

5. V.F. me detyrë Specialiste e Zyrës së taksave, për veprime në kundërshtim me nenin 91 dhe 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore".

c."Vërejtje me shkrim", për 6 punonjësit për:

1. G.L. ish-shefi i zyrës shërbimeve, për periudhën 8 mujore, nga data 02.04.2012 deri 01.12.2012, aktualisht specialist në zyrën e taksave.

2. **Q.P.** ish-shefi i zyrës së shërbimeve për vitin 2011 deri 02.04.2012, aktualisht specialist në zyrën e taksave.

3. **B.XH.** specialist në zyrën e shërbimeve, nga data 03.01.2012 e në vazhdim.

4. **B.R.** punonjëse faturiste.

5. **SH.XH.** arkëtar shëtitës.

Për veprime në kundërshtim UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njëjësive të sektorit publik", VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.2007 dhe udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për administrimin e ujit të pijshëm.

6. **M.H.** shefe e zyrës së menaxhimit dhe mbrojtjes së tokave , për veprime në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.02.2011 "Mënyra e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki" Kreu IV -Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, në Komuna dhe Bashki, pika 2, shkronja c) dhe VKM nr. 532, datë 31.10.2002, "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në Qark dhe zyrat e Menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në Komunë dhe Bashki", Paragrafi i II-të -Funksionet dhe detyrat e zyrës së Menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pika 3.

ç. "Vërejtje me paralajmërim", për:

1. **H.U.** agronom, specialist në zyrën e bujqësisë, pyjeve dhe kullotave në cilësinë e anëtarit të bordit të dhënies me qira të tokave të pandara, për veprime në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pika 2, 3/d, 6 (a, b, c), 11.

2. **N.K.** punonjës i Policisë së Komunës, për veprime në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të Komunës", nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 "Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës" dhe për mos zbatim të Rregullores së brendshme të administratës së komunës miratuar me VKB nr. 17, datë 05.05.2009 pika 14 -Detyrat e policisë së komunës.

3. **M.K.** me detyrë inspektor i inspektoratit ndërtimor urbanistik të komunës, për veprime në kundërshtim me pikën 8 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor", ku përcaktohet se: Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzim penal për kundërvajtjen.

E. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 06, datë 31.07.2013, vërejtjeve të subjektit të audituar.

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar dhe nenin 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" i ndryshuar, **i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës, Zall-Herr të vlerësojë shkeljet e**

konstatuara, e të vendosë deri sanksion administrativ, (dënimin me gjobë) ndaj **z. K.S. mbikëqyrës i punimeve**, për veprime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos të punimeve të ndërtimit” Kreut I, pika 1, A, ku përcaktohet: “Në punimet e ndërtimit në të gjitha rastet përjashtohen aparaturat dhe pasjet”, duke shkaktuar dëm ekonomik, UKM nr. 01, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 03, datë 15.02.2001, pikat 7.1, 7.2 dhe 7.3 të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 ”Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II -Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001.

Për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Tiranë.

I rekomandojmë Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit Tiranë, që të marrë masë disiplinore ndaj z. S.B. në cilësinë e anëtarit të Bordit të dhënies me qira të tokave, në Komunën Zall-Herr, përfaqësuesi i Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë , për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 2 -Kryetari dhe sekretari, neni 16 -Procesverbali i mbledhjes, neni 17 -Përfshirja në procesverbal e votave "kundër" dhe nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001.

- Për Ministrinë e Drejtësisë

Për shkeljet e konstatuara në dokumentet shkresore të hartuara, pranuar dhe noterizuara, konkretisht kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, bazuar në nenin 8 shkronja “ç” të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë” i rekomandojmë, **Ministrin të Drejtësisë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave përkatëse në raport me shkeljet e konstatuara, **për 2 noterë publikë E.L dhe SH.SH** për hartimin dhe noterizimin e 19 kontratave, ku pasuritë janë noterizuar pa ju transferuar me VKM, komunës Zall-Herr, pra , (madje nuk figurojnë as në listat paraprake), të miratuara me VKM në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18 -**Dokumentacioni i transferimit** dhe nenin 678, të **Kodit Civil**, ku përcaktohet se: “*Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*”.

4. Hartimi dhe noterizimi i kontratave është kryer pa ju përmbajtur detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, neni 54, Procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, ku përcaktohet: Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, **pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm.**

F. KALLZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 732/17, datë 31.12.2013 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë

3 H.B. në cilësinë e juristit të komunës Zall-Herr dhe personit të caktuar me mbajtjen e protokollit të mbledhjeve të Bordit, nuk ka përmbushur detyrën, në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 2 -Kryetari dhe sekretari, neni 16 Procesverbali i mbledhjes, neni 17 -Përfshirja në procesverbal e votave "kundër”.

Dhënia me qira e tokave bujqësore nga komuna Zall-Herr, është kryer pa ju transferuar me VKM, pra pa i pasur ato në pronësi dhe pa i regjistruar në ZVRPP në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni.

Kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara të Komunës Zall-Herr, mbi të cilin kanë lindur marrëdhëniet kontraktuale, janë absolutisht të pavlefshme në kundërshtim me sa përcakton

neni 678 e vijues të Kodit Civil, ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ndryshuar me: ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë) detyrat e këshillit bashkiak ose komunal. *miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.* Nga 188 kontrata të lidhura për dhënien me qira të tokave të pandara, me sipërfaqe prej 360 ha, në 106 kontrata me sipërfaqe prej 160 ha, kontratat e lidhura me qiramarrësit nuk janë TIP (sipas formatit ligjor), në to nuk janë vendosur sanksione, për të cilat nuk mund të llogariten kamat vonesa, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip" të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore" dhe UKM nr. 3, datë 16.05.2007.

Nga mos ndjekja e zbatimit të kontratave të lidhura për dhënien me qira për tokat bujqësore të pandara për 54 persona, nuk janë llogaritur sanksionet e parashikuara në kontratë në masën 1% në ditë të vlerës së kontratës, duke u krijuar një e ardhur e munguar në vlerën prej 1,749,241 lekë, nga e cila 20 persona kanë shkelur kontratat dhe duhet të ngarkohen me kamat vonesë në masën 0.1% në ditë në vlerën prej 1,590,747 lekë dhe vlera prej 158,494 lekë, përfaqëson mos shlyerjen deri më datën 30.06.2013 të vlerës së kontratës, në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 16.05.2007.

Ka pranuar dhe depozituar në Komunë, 188 kontratat e qirave të tokave të pandara të cilat nuk ishin të regjistruar në ZVRPP, Tiranë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", pika 11 dhe pika 14.

Dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, është bërë për një afat prej 99 vjetësh, ndërkohë nga 188 kontratat e hartuara dhe lidhura, vetëm 19 prej tyre janë noterizuar, duke vepruar në kundërshtim me Kodin Civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 i ndryshuar, neni 826, ku përcaktohet se: Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik. Nga mos kontrolli dhe mos inventarizimi i dokumenteve ka lejuar që të lidhen 188 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, me një afat prej 99 vjetësh, ndërkohë që kontratat nuk janë protokolluar në zyrën e arkivit të komunës dhe dosjet nuk kanë qenë të plota, pasi në to mungojnë 357 dokumente të përcaktuara në UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", pika 2, 3/d, 6 (a, b, c), 11 dhe 14.

Anëtarët e Bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara shkurt (BQTBP-ja), si më poshtë:

- 1.F.L.** inxhinier topograf i komunës, përfaqësuesi i urbanistikës së komunës, në cilësinë e anëtarit të bordit të dhënies me qira të tokave të pandara.
- 2.H.U.** agronom, specialist në zyrën e bujqësisë, pyjeve dhe kullotave vendore në cilësinë e antarit të bordit të dhënies me qira të tokave të pandara.
- 3.S.B.** përfaqësuesi i Drejtorisë Bujqësisë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të bordit të dhënies me qira të tokave të pandara.
- 4.N.K.** ish-përfaqësues i Këshillit të Qarkut, Tiranë, (aktualisht në Pension pleqërie), për të cilin rezulton se ka nënshkruar mbi 10 vendime të Bordit, në cilësinë e anëtarit të bordit të dhënies me qira të tokave të pandara.

Marrjen e vendimeve nga Bordi për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, për 188 persona më sipërfaqen 360 ha pa ju transferuar më parë prona komunës Zall-Herr, me Vendim të Këshillit Ministrave (disponibiliteti e administrimi), *pra pa i pasur ato në pronësi dhe pa i regjistruar në ZVRPP* në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", neni 18.

Nga mos kontrolli i dokumentacionit për vendim marrje Bordi për 188 persona për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, për sipërfaqen prej 360 ha, dosjet nuk ishin plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar në UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pika 2, 3/d, 6 (a, b, c), 11 dhe pasi në to mungojnë 357 dokumente, si: Kërkesa e qiramarrësit, Formulari Tip i aplikimit, Plani i Rivelimit, Plani i Biznesit, etj.

Për 82 qiramarrës, nuk kishin filluar fare punimet, duke mos respektuar zbatimin e kontratave, nga anëtarët e Bordit, nuk është ushtruar kontroll për zbatimin e kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në kundërshtim me pikën 3 shkronjat a,d, të UKM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" i ndryshuar, shkronja d.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga Komuna Zall-Herr janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 575/14 datë 07.01.2014, pra rezulton se **rekomandimet janë pranuar**, dhe janë në marrë masat për zbatimin e tyre.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako dhe Mirland Cela, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT